



Datë: 17.03.2026
Numër Protokollit: 1383/2026

A.nr.1950/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi- Bajraktari, anëtare, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1950/2025, të datës 26.11.2025, të parashtruar nga ankuesi B.T, kundër organit të punësimit/Ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*pezullim nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.19593/2025, e datës 26.11.2025 e parashtruar nga ankuesi B.T, **shfuqizohet** Vendimi me numër të protokollit, 10521 i datës 12.11.2025 si dhe vendimi me numër protokollit 10594/01 i datës 13.11.2025, i ushtruesit të detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent

A r s y e t i m

Ankuesi B.T (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 26.11.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e regjistruar nën shenjë A.nr.1950/2025, kundër Vendimit me numër të protokollit 10521 i datës 12.11.2025 si dhe vendimi me numër protokollit 10594/01 i datës 13.11.2025, të ushtruesit të detyrës së, Sekretarit të Përgjithshëm, të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 04.12.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (*tutje referuar MMPHII*), ndërsa, kjo e fundit, më datë 10.12.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 7587/2025 të datës 26.11.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 10593 të datës 13.11.2025; Vendimin me numër protokolli 10521 të datës 12.11.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 04.12.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 10.12.2025; Akt Emërimit të datës 03.07.2014; Akt emërimit të datës 18.04.2016; Autorizimin e datës 13.11.2025 lidhur me përfaqësim të ankuesit.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, ***sepse:***

Nga provat e administruara rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 18.04.2016, është e punësuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Pyetës në MMPHI .

Tutje, sipas provave të lëndës, rrjedhë se Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MMPHI, më datë 30.07.2025 ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë të informohet nëse ndaj zyrtarëve të caktuar në listë respektivisht nga ankuesit B.T a ka të ngritur aktakuzë, ndërsa Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 25.09.2025, ka njoftuar se ndaj ankuesit B.T është ngritur aktakuzë dhe është aktive në Gjykatën Themelore akti me nr. PS.nr.14/2015 me numër unik të lëndës SMIL 2020:057879 për veprën penale *Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar*.

Ushtruesi i Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në MMPHI, fillimisht më datë 12.11.2025 ka nxjerrë Vendim me numër të protokollit 10521, me të cilët ankuesin e ka pezulluar nga marrëdhënia e punës sipas detyrës zyrtare nga data 29.09.2025, me kompensim të pagës së tij deri në pesëdhjetë (50 %) deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër, ndërsa me datë 13.11.2025 po i njëjti ka nxjerr vendimin me numër protokolli 10593 me të cilët ankuesin e ka pezulluar nga marrëdhënia e punës sipas detyrës zyrtare nga data 12.11.2025 me kompensim të pagës së tij deri në pesëdhjetë (50 %) deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër.

Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës të bashkëngjitura nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesi është pezulluar nga puna duke u bazuar në një aktakuzë të vitit 2015 nr. PS.nr.14/15 ndërsa në shkresat e lëndës është bashkëngjitur një aktakuzë e vitit 2022 nr.PPS.nr.40/2019 datë 18.02.2022 prandaj Kolegji ka konstatuar se ekziston një lajthim juridik i cili duhet të sqarohet nga ana e organit punëdhënës dhe të merret vendim i drejtë duke u bazuar në aktin akuzues që është në fuqi nëse ka një të tillë. Kolegji duke mos paragjykuar çështjen përfundimtare për shkak të lajthimit juridik ka vendosur që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent.

Andaj, për sa u tha më sipër, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të refuzoj si të pabazuar ankesën dhe të lejë në fuqi aktin e kundërshtuar me ankesë, respektivisht vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA, A.NR.1950/2025**

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit B.T;
- Sekretarit të Përgjithshëm në MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.